



Shpallje për vend të lirë pune

Psikolog/e

Kohëzgjatja	30 Qershor 2026, kontratë në përputhje me ligjin vendas.
Pozicion me kohë të plotë	40 orë / javë
Pagesa	Pagesa në monedhën vendase
Raporton direkt tek	Menaxher i Programit për Mbrojtjen e Fëmijëve
Vendi i punës	Kukës, Shqipëri

Afati i fundit për aplikime: 09 Mars 2025

INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR MISIONIN E TDH NË SHQIPËRI

Terre des hommes (Tdh) Misioni në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse që operon për mbi 30 vjet në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë ndër kontribuuesit kryesorë në ngritjen dhe forcimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Tdh Shqipëri po zbaton programe në fushën e migracionit dhe antitrafikimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe aksesit në drejtësi. Tdh Shqipëri punon në partneritet të ngushtë me aktorë kombëtarë dhe vendorë në advokimin, forcimin e sistemit dhe zbatimin e modeleve të shërbimeve, qasjeve dhe nismave që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve në nevojë.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH PROJEKTIT

Terre des hommes Shqipëri, në kuadër Projekti "Ngritja e Shërbimeve të Specializuara - Qendra Multifunkionale për Mirëqenie Psikosociale në Kukës", pjesë e programit "EU4SocialCare", financuar nga European Union dhe implementuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania, ka qëllim të adresojë mangësitë lidhur me ofrimin e shërbimeve psikosociale në Bashkinë Kukës. Qendra multifunkionale do të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët, të rinjtë dhe kujdestarët e tyre, të prekur nga trauma, kriza ose situata të vështira. Përmes shërbimeve si Ndhima e Parë Psikologjike, Informimi për përkujdesjen nga traumat psikologjike, Këshillimi mbështetës, Psiko-edukimi dhe Aktivitetet psikosociale në komunitet, projekti do të përmirësojë aksesin në shërbimet e shëndetit mendor, duke nxitur reziliencën tek përfituesit. Qendra do të krijojë gjithashtu një sistem të koordinuar menaxhimi rastesh dhe referimesh, duke garantuar lidhjen e shpejtë dhe efektive të përfituesve me shërbimet e duhura.

QËLLIMI I POZICIONIT:

Psikologu në këtë projekt do të ofrojë mbështetje të specializuar psikologjike për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e prekura nga trauma dhe krizat. Ai/Ajo do të kryejë vlerësime të shëndetit mendor, do të zhvillojë plane të personalizuara ndërhyrjeje dhe do të ofrojë këshillim individual dhe në grup për të ndihmuar përfituesit të përballojnë vështirësitë emocionale. Përveç ofrimit të mbështetjes terapeutike, ky rol do të fokusohet në reduktimin e paragjykitimit ndaj shëndetit mendor, fuqizimin e komunitetit përmes psikoedukimit dhe bashkëpunimin me aktorët lokalë për të siguruar një sistem gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të kujdesit psikosocial.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE





- Ofron mbështetje të menjëhershme psikologjike për individët, veçanërisht fëmijët, të rinjtë dhe familjet e prekura nga trauma ose krizat, për të stabilizuar gjendjen emocionale dhe për të mundësuar sigurinë psikologjike.
- Ofron këshillim mbështetës për të ndihmuar përfituesit të menaxhojnë traumën, të zhvillojnë mekanizma përballimi dhe të ndërtojnë qëndrueshmëri për një shërim afatgjatë të shëndetit mendor.
- Kryen vlerësimeve psikologjike për të identifikuar nevojat për shëndetin mendor dhe zhvillon planeve të personalizuara të ndërhyrjes për individët dhe familjet.
- Harton dhe lehtëson sesione mbi ndërgjegjësimin dhe psikoedukimin në komunitet, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e projektit dhe aktorët lokalë.
- Ndjek dhe vlerëson efektivitetin e të shërbimeve të qendrës, mbledh përshtypje nga përfituesit dhe përgatit raporte për të siguruar cilësinë dhe ndikimin e programit.
- Ofron seanca të këshillimit mbështetës për fëmijët, të rinjtë dhe familjet për të adresuar shqetësimet emocionale dhe traumat.
- Ofron mbështetje të shëndetit emocional afatgjatë përmes kujdesit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të procesit të rikuperimit.
- Bashkëpunon me asistentin e projektit për të krijuar plane të personalizuara të kujdesit bazuar në nevojat e identifikuara.
- Mbështet sistemin e menaxhimit të rasteve duke ofruar informacion psikologjik thelbësor për kujdesin e vazhdueshëm dhe ndjekjen e rasteve.
- Vlerëson dhe referon individët që kanë nevojë për shërbime të specializuara të shëndetit mendor ose mbështetje tek ofruesit e jashtëm përkatës.
- Sigurohet që referimet të jenë të koordinuara mirë dhe që përfituesit të marrin shërbimet e duhura në kohën e duhur.
- Zhvillon sesione psiko-edukuese për individët dhe familjet për të përmirësuar kuptimin e tyre mbi traumën, shëndetin mendor dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme.
- Promovon strategjinë e kujdesit për veten për të ndihmuar individët të menaxhojnë shëndetin e tyre mendor dhe të ndërtojnë qëndrueshmëri.
- Përgatit raporte të detajuara mbi shërbimet psikologjike, duke përfshirë progresin, sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin e projektit.
- Ndjek rezultatet, mbledh përshtypjet dhe përdor të dhënat për të përmirësuar zbatimin e projektit.

PROFILI JUAJ

- Diplomë universitare ose specializim në Psikologji.
- Të jetë anëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.
- Minimumi 2-3 vjet përvojë pune në role të ngjashme, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve psikologjike.
- Eksperiencë e mëparshme pune me OJF dhe shërbimin social përbën avantazh.
- Eksperiencë e mëparshme pune në menaxhim rasti.
- Eksperiencë me sisteme të menaxhimit të të dhënave dhe raportimit për ndjekjen dhe monitorimin e rasteve.
- Aftësi të mira në kryerjen e vlerësimeve psikologjike dhe përdorimin e mjeteve të standardizuara.
- Aftësi të forta komunikuese dhe dëgjim aktiv.
- Proaktivitet, energji dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur.
- Për këtë pozicion preferohet njohja shumë e mirë e gjuhës angleze.
- Aftësi të mira në përdorimin e paketës Microsoft Office (Word, Excel, PowerPoint), Microsoft Teams, Zoom, etj.).

PËR TË APLIKUAR

Aplikantët e kualifikuar inkurajohen të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivimi me email në adresën alb.hr@tdh.org duke përfshirë në titullin e e-mailit "**Aplikim për Psikolog/e, UN- EU4SI**".

** Ju lutemi vini re se aplikimet e marra pas afatit nuk do të merren parasysh. Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve, Tdh nuk është në gjendje t'u përgjigjet të gjithëve individualisht. Ju lutemi vini re se vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.*

Politika e mbrojtjes së fëmijëve:

Tdh (përfshirë anëtarët e stafit, kontraktorët, konsulentët) janë të përkushtuar të respektojnë Politikën e Menaxhimit të Rrezikut Tdh duke përfshirë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e sigurisë dhe politikën kundër mashtrimit/korrupsionit, politikën e sinjalizimit. Për më shumë ju lutem referojuni lidhjes së mëposhtme <https://www.tdh.org/en/about-us/ethics-committments> .

Pajtueshmëria me RrPMDh (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave):

Privatësia juaj është e rëndësishme për ne.

Duke dërguar aplikimin tuaj, ju pranoni që të dhënat tuaja personale të përdoren në procesin e rekrutimit.

Çdo informacion personal i dhënë nga ju gjatë procesit të aplikimit do të trajtohet me konfidencialitet dhe do të përdoret vetëm për qëllimin e vlerësimit të kandidaturës suaj për punësim. Jini të sigurt se të dhënat tuaja nuk do të ndahen me palët e treta pa pëlqimin tuaj të qartë dhe do të ruhen në mënyrë të sigurt në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.